



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.297, Datë 10.11.2022

PËR
“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN ADNAN XHOLI”

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Adnan Xholi:
 - si personel akademik me kohë të pjesshme, për një semestër, për lëndën “procedura penale e avancuar me praktikë gjyqësore”, pranë Kolegjit Universitar “Bedër” Tiranë, për periudhën kohore që përfshin vitin akademik 2022-2023 dhe;
 - si udhëheqës shkencor, ose/dhe specialist pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën kohore që përfshin vitin akademik 2022-2023.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Adnan Xholi, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 10.11.2022.

KRYETAR

Alfred Balla

